



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:081665

Datë: 05.05.2023

Numri i dokumentit: 04255742

PA1.nr.141/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani kryetari i kolegjit, Skender Çoçaj dhe Abdullah Ahmeti anëtarë, me procesmbajtësen Lirika Sylaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit F. B. nga S, për shkak të veprës penale shantazhi nga neni 329 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren dhe ankesën e mbrojtësve të akuzuarit, avokatëve B. K. dhe A. K. , të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.1128/2021, datë 04.11.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me 31.03.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

II. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa e mbrojtësve të akuzuarit, avokatëve B. K. dhe A. K. , **ndryshohet** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.1128/2021, datë 04.11.2022, përkitazi me vendimin për dënimin, ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës, të akuzuarit F. B., për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit në pajtim me nenin 44 të KPRK i zëvendësohet me dënim me gjobë ashtu që të akuzuarit i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 3500 (tremijë pesëqindë) euro, si dhe dënimin me gjobë në shumën prej 500 (pesëqindë) euro, ashtu që gjykata të njëjtit i shqipton dënimin unik me gjobë në shumën prej 4000 (katërmijë) euro, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari nuk mundet apo nuk dëshiron ta paguajë gjobën, atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për çdo 20 euro të gjobës do ti llogaritet një ditë burgim.

Në pjesët tjera aktgjykimi i ankimuar mbetet i pa prekur.

II. Refuzohet si e pa bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prizren me aktgjykimin P.nr.1128/2021, datë 04.11.2022, të akuzuarin F. B. e ka shpallur fajtor për veprën penale shantazhi nga neni 329 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej nga 7 muajve.

I akuzuari obligohet që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20 euro, në emër të Kompensimit të Viktimave të Krimit shumë prej nga 30 euro të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të akuzuarit i konfiskohet telefoni mobil "Iphone X-S" ngjyrë ari me nr. IMEI357212098179682 si objekt i kryerjes së veprës penale.

E dëmtuara B. G. , për realizimin e kërkesës pasurore - juridike, udhëzohet në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor kanë paraqitur ankesë:

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje të ligjit penal dhe vendimit mbi sanksionin penal duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës, që aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj ashtu që të akuzuarit t'i shqiptojë dënim me burg efektiv më të lartë.

Mbrojtësit e të akuzuarit avokatëve B. K. dhe A. K. ankesë të përbashkët për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe vendimit mbi sanksionin penal duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës, që aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj sa i përket vendimit mbi dënim ashtu që të akuzuarit ti shqiptoj dënim më të butë përkatësisht dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muajve dhe në pajtim me nenin 44 të KPRK ti zëvendësohet me dënim me gjobë ose të njëjtit ti shqiptoj dënim me kusht sipas nenit 48 të KPRK, ose të anulohet aktgjykimin i ankimuar dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallë së parë në rigjykim dhe vendim.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtrësën PPA/II.nr.183/2022, të datës 03.02.2023, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren ashtuqë të ndryshohet aktgjykimin i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit F. B. ti shqiptohet dënim më i lartë me burgim efektiv dhe dënim më të lartë me gjobë. Të refuzohet ankesa e përbashkët e mbrojtësve të akuzuarit, AV B. K. dhe A. K. e ushtruar kundër aktgjykimit Gjykata Themelore në Prizren P.nr.1128/2021, datë 04.11.2022.

Në ankesë Prokuroria pretendon se aktgjykimin i ankimuar në pjesën ndëshkuese është në kundërshtim me vetveten dhe me arsyet e paraqitura në arsyetim, dispozitivi është i pa qartë i pa

kuptueshëm me arsyetimin lidhur me faktet vendimtare ku në dispozitiv janë përshkruar veprimet inkriminuese për veprën penale të kryer ndërsa nuk jepet asnjë fakt vendimtar lidhur me dënimin e shqiptuar, duke pas parasysh mënyrë dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, pasojat, ndërsa gjykata nuk cek se cilat ishin ato rrethana veçanërisht lehtësuese të cilat kanë ndikuar në shqiptimin e dënimit me burgim, gjykata nuk i ka vlerësuar drejtë rrethanat rënduese, përkatësisht shkallën e lartë të dashjes për kryerjen e veprës penale, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, shqetësimin e madh të dëmtuarës, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, faktin se i pandehuri me veprimet e tija ka cenuar nderin dhe autoritetin e të dëmtuarës. Si pasojë e këtyre shkeljeve është shkelë edhe ligji penal në dobi të akuzuarit sepse çdo pranim i fajësisë nuk nënkupton që gjykata duhet të shqiptoj dënim të ulët. Gjukata e shkallë së parë i ka mbivlerësuar rrethanat lehtësuese ndërsa nuk i ka vlerësuar drejtë rrethanat rënduese me ç'rast edhe i ka shqiptuar sanksion penal tejet të butë me të cilin nuk mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK, me që rast edhe është aplikuar politikë ndëshkimore tejet e butë.

Mbrojtësit e të akuzuarit në ankesë pretendojnë se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës penale, kur me rastin e pranimit të fajësisë nga i akuzuari nuk i është dhënë fjala mbrojtjes që të deklarohet lidhur me pranimin e fajësisë si dhe rrethanave lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit si dhe lidhur me rrethanat personale të pandehurit dhe rrethanat lehtësuese. Po ashtu mbrojtja pretendon se gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimit nuk i ka marrë parasysh të gjitha benefitet ligjore që dalin nga pranimi i fajësisë për faktin se të akuzuarit dhe mbrojtjes nuk i është dhënë e drejta që ti përmend rrethanat lehtësuese dhe personale që do të ndikonin në shqiptimin e kufirit të dënimit në minimum, gjykata nuk i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese por vetëm i ka përmendur në mënyrë të përgjithshme dhe atë vetëm pranimin e fajësisë, në këtë rast janë edhe rrethanat tjera lehtësuese si rrethanat personale të akuzuarit dhe sjellja e tij pas kryerjes së veprës penale gjendja familjare dhe psikike e të akuzuarit, dhe atë i akuzuari është baba i dy fëmijëve, të cilët janë të martuar që satausi i tij është edhe gjysh, ka prindër dhe familje të respektuar në rreth me kontribut shoqëror, është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, sjellja e tij korrekte para organeve të drejtësisë, ndjeshmëria e rastit pendimi i tij i thellë dhe keq ardhja për rastin.

Gjukata e Apelit caktoi dhe mbajti seancën e kolegjit, konform dispozitës së nenit 390 të KPP-së në të cilën prezantuan i akuzuari F. B. dhe mbrojtësit e tijë Av. B. K. dhe A. K. si dhe përfaqësuesja e të dëmtuarës B. G. Av. B. H.. Prokurori i Apelit dhe e dëmtuara B. G. edhe pse të njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt nuk prezantuan në seancë. Përfaqësuesja e të dëmtuarës B. G. Av. B. H. deklaroi se e mbështetë ankesën e Prokurorisë themelore në Prizren, mbrojtësit e të akuzuarit Av. B. K. dhe A. K. deklaruan se mbesint në tërësi pranë ankesës së ushtruar me shkrim, me tej të njëjtën e elaboron, i akuzuari deklaroi se i mbështetë deklaramet e mbrojtësve duke shtuar se është penduar dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprën penale.

Kolegji penal i Gjukatës së Apelit të Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj pretendimet ankimore dhe analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394, paragrafi 1. të KPP, konstatoj se :

- ankesa mbrojtësve të akuzuarit është pjesërisht e bazuar, ndërsa ankesa e Prokurorisë është e pabazuar.

Duke vlerësuar pretendimet në ankesën Prokurorisë Themelore në Prizren dhe ankesën e mbrojtësve të akuzuarit, avokatëve B. K. dhe A. K. , Gjykata e Apelit këto shkelje edhe sipas detyrës zyrtare i shqyrtoi në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPPRK-së dhe konstatoi se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar, ngase dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, në të nuk ka kundërthënie me vetveten e as me arsyet e tij, është i qartë dhe konkret. Aktgjykimi i ankimuar përmban arsyet e duhura mbi të gjitha faktet relevante të kësaj çështje penale dhe se gjykata e shkallës se ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta, objektive dhe të ligjshme, i aprovon edhe kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës.

Sa i përket vendimit mbi sanksionin penal sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit të Kosovës pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e mbrojtësve të akuzuarit janë pjesërisht të bazuara. Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimit i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, mirëpo nuk i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese të rastit konkret, në këtë drejtim, gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimit, si rrethanë lehtësuese ka marrë vetëm pranimin e fajësisë dhe keqardhjen e shprehur për rastin, ndërsa si rrethana rënduese ka marrë shkallën e përgjegjësisë penale, shkallën e lartë të pjesëmarrjes dhe të dashjes në kryerjen e veprës penale, shkallën e lartë të vetëdijes dhe dëshirës për të kryer veprën penale këmbëngulësinë e të akuzuarit.

Vlerësimin e këtyre rrethanave relevante për matjen e dënimit nga ana e gjykatës së shkallës së parë e pranon edhe kjo gjykatë, mirëpo gjen se në rastin konkret në kuptim të nenit 69 par. 3 pika 3.3 të KPRK duhet të merren parasysh edhe rrethanat tjera lehtësuese të paraqitura në ankesën e mbrojtësve të akuzuarit dhe të vet akuzuarit dhe atë rrethanat personale të akuzuarit dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale gjendja familjare dhe psikike e të akuzuarit, se i akuzuari është baba i dy fëmijëve, të cilët janë të martuar që statusi i tij është edhe gjysh, ka prindër dhe familje të respektuar në rreth me kontribut shoqëror, është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, sjellja e tij korrekte para organeve të drejtësisë, ndjeshmëria e rastit pendimi i tij i thellë dhe keqardhja për rastin, dhe në praninë edhe të këtyre rrethanave kolegji vlerësoj se ndaj të akuzuarit ka hapësirë që të shqiptohet një dënim më i butë, andaj të akuzuarit i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se edhe një dënim i tillë është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe me intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, e posaçërisht duhet të jenë në funksion të preventives gjenerale dhe individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga kjo gjykatë do të arrihet edhe qëllimi i dënimit. Ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren është

refuzuar si e pabazuar, për faktin se në ankesë nuk ka ofruar ndonjë rrethanë posaçërisht rënduese të cilën nuk e ka marrë për bazë gjykata e shkallës së parë.

Nga sa u tha më lartë në pajtim me dispozitën e nenit 403 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.141/2023, me datën 31.03.2023

Procesmbajtëse,
Lirika Sylaj

Anëtarët e kolegjit:
Skender Çoçaj

Kryetar i kolegjit,
Ferit Osmani

Abdullah Ahmeti
